**PROCES VERBAL**

Mbajtur sot me datë: 31.10.2022, ora 10:00 në Njësinë Administrative Xibër, për hartimin e projekt- buxhetit 2023 dhe Paketës Fiskale 2023.

Marrin pjesë kryetari i Bashkisë, Nënkryetarja e Bashkisë, Administratori i Njësisë Administrative Xibër, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve financiare si dhe banorë të zonës.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë & tregon arsyen për të cilën jemë mbledhur për të marrë kërkesat dhe mendimet e banorëve të njësisë dhe për ti pasur parasysh gjatë hartimit të Buxhetit 2023, PBA 2023-2025 dhe paketës fiskale të vitit 2023.

Kryetari tregon që është bërë projekti i rrugës nga Shkalle në Gurë të Bardhë & për vitin 2023 do të bëhet projekti nga Shkalle – Qendra Shëndetësore.

Thotë që vaditja është akoma problem për fshatin këtë. Lajm i mirë është investimi që do të realizohet në ujësjellësin e fshatrave të NJ.Adm. Xibër.

Sali Muca falenderon për punët e bera & shpreh shqetësim në lidhje me problematikat në kanale vaditëse duhen 300 ml tubë në këtë. Paraqet kërkesë për rrugën Una e betonit këtë deri te rruga e Skoriut.

Shfaq problematikë për pyjet e prera pa kriter nga banorë jo të zonës.

Resul Boleta (banori fshatit Gurë i Bardhë) ka kërkesë për rrugën me kalldrëm nga mulliri te dygani & që të mbushen gropat e rrugës kryesore të Gurit të Bardhë.

Problematikë mbeten ujërat e zeza nga mulliri te dygani & ura me hark që jemë në rrezik.

Kryetari përgjigjet që brenda javës do të ndërhyhet në këto ura.

Do të bëhet pastrim i rrugës së vjetër nga Baletas deri te Shomet.

Flet Atnand Memo (banor i fshatit Xibër Murrizë)

Paraqet problematikat që jemë në pyje & tregon që nuk kemë mundësi që ta ruajmë, si dhe për mbetjet që hidhen në pyll nga banorët jo-vendas.

Kërkon ndërhyrje për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore.

Administratori i Njësisë shpjegon që vizitat do bëhen edhe

në Klos, por në ambulancë do ketë edhe mjekë nga Klosi.
Në lidhje me vaditje tregon që është bërë shumë punë
vetëm dy lagje që e marrin ujin me tuba kanë probleme
kërkesa është që rruga e re të lidhet deri te fisi Fejza
Rruga e Mserjes e hapur prej vitesh nëpër të cilën kalojnë
shumë banorë, kërkon mbushje.
Kryetari tregon që për vitin 2023, kjo do të jetë prioritet.
Sabri Neli (banor i fshatit Xibër Hane) ka kërkesë
për 200ml tubë për kanalin vaditës si dhe për rrugën që
lidh Ketën me Xibër Hanen.
Kërkon ndërhyrje për sistemimin e rrugës nga shpia e Rizajt
e lart.
Kryetari shpjegon që do ti ketë parasysh të gjitha rrugët për
rikonstruksion.
Mom fjalën Avni (fshati Guri i Bardhë).
ka kërkesë për orientimin e njerëzve nga sinjalistikës në
rrugë. Kryetari shpjegon që e ka buxhetin për këtë & do
ta realizojë sinjalistikën rrugore.
Resul Bateta (G. Bardhë) ka kërkesë për investim në fushën
e artit për zonën e Xibrit që të kenë ambient kulturor.
Kryetari tregon që janë realizuar festa me pjesëmarrës nga
të 4 njësitë administrative & do të realizohen përsëri për
rastin e 28-29 Nëntorit & Vitit të Ri.
Do ngrihet qendra kulturore fillimisht në Klos e më pas në
njësitë e tjera.
Drejtori Shkollës Naim Muça tregon që me nxënësit, ka marrë
pjesë në aktivitete. Banorët kanë kërkesë për rrethimin &
sistemimin e varrezave.
Hysen (banor i Lagjes Hoxha) ka kërkesë për rrugën kryesore deri
te Fejza & që kanali të bëhet me beton, & të hapë një segment rruge.
Sabri Neli ka kërkesë për pazarin në zonën e Xibrit për prodhimet
bujqësore e blektorale, por kryetari thotë që pazari do bëhet në
qytetin e Klosit, si gjithmonë. Gjithashtu kryetari sqaron që guroja
që pretendohej të bëhej nga firma, nuk do të bëhet.

**Drejtor i B. Njerëzore, Ç. Juridike dhe Sh. Financiare**

Enduina Neli